

PROCESVERBAL 20/2023

I mbajtur me rastin e takimit të 11 (njëmbëdhjetë) të rregullt për vitin 2023 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 20.12.2023 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës në Suharekë;

4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;

5.Të ndryshme;

Takimin e hapi kryesuesi Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime sa i përket kësaj pike dhe thotë që ky projekt vendim ka të bëjë me formimin e komisionit për të zhvilluar procedurat e ankandit publik.Është komision që është i bazuar në ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.Besoj që edhe në Kuvend e merr pëlqimin dhe miratohet ku dhe propozohen anëtarët nga subjektet e ndryshme politike,nga ekzekutivi dhe nga shoqëria civile.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës në Suharekë;

Avni Bytyqi - planin e punës e kemi hartu në bashkëpunim me ekzekutivin dhe me një takim që kemi pas me KPF-në.Besoj dhe do të mundohemi që ti realizojmë gjithë ato objektiva apo aktivitete që i kemi

parapa në kuadër të këtij planifikimi dhe presim nëse keni ju ndonjë koment.

Kryesuesi - hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3.

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor të punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;

Avni Bytyqi - unë si koordinator i KKSB-së në bashkëpunim me kryesuesin e KKSB-së Kryeatrin e Komunës dhe arterët kryesor që janë anëtarët e KKSB-së,e kemi hartu planin e punës për vitin 2024 ku e kemi parapa që së paku ti mbajmë 6 takime në vitin 2024 duke i përfshirë të gjitha pikat e rendit të ditës apo duke planifikuar të gjitha aktivitetet dhe objektivat me qëllim që t'ju sigurojmë qytetarëve siguri të qetë në territorin Komunës së Suharekës.Në KPF e kemi diskutu dhe komiteti e ka përcjell për Kuvend dhe presim edhe nga juaj që të jepni sugjerimet e juaja dhe të përcillet për Kuvend për miratim.

Denis Sofra - hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 4.

Aprovohet pika 4.

Pika 5.Të ndryshme;

Kryesuesi - sa i përket takimeve unë jam shumë falemderues dhe për koordinatorin dhe të gjithë akterët tjerë që janë të involvun në këtë komitet për arsye se pothuaj që jemi Komuna e vetme e cila i ka mbajtur takime më së shumti sa i përket komunitetit duke e pasë parasysh që Komunitat tjera janë shumë mbrapa takimeve dhe pikat që janë diskutu kanë qenë me rëndësi të veçantë.Kemi pas një pikë që ka buru nga këtu si kërkesë për lagjen “Sllogja”,për zhvendosjen e atyre shtëpive ku ajo lagje u zhvendos dhe janë ndërto shtëpitë dhe për ne ka qenë një plus i madh si komunitete.Kemi edhe disa pika që ne nuk kemi marrë përgjigje.Plan të punës nuk kemi si komunitete por e kemi pikën të ndryshme ku mundemi me dal me kërkesa dhe rekomandimet tona.

Nazim Shabanaj - ne jemi të kënaqur me punën e këtij viti dhe uroj që në vitin 2024 të punojmë edhe më mirë. Ju uroj shëndet e suksese.

Takimi përfundoi: 09:15